



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:024741

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05760093

KPPP.nr.710/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Ameba Sh.P.K., me seli në Suharekë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokate Flutura Rraqi me seli të zyrës në Suharekë, kundër debitorit A.R.B. B.I., me seli në Prishtinë, rruga “Bardhyl Çausi” Obj. E, nr.7, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Labinot Vata me seli të zyrës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.7/2023 të datës 10.01.2023, të Përmbartuesit Privat Liridon Tërshani, me seli të zyrës në Prizren, jashtë seancës me datën 14.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit A.R.B. B.I., ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.7/2023 i datës 10.01.2023, i nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Liridon Tërshani.
- II. Detyrohet kreditori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj debitorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë në shumë të përgjithshme prej 78 €, në emër të përpilimit të prapësimin nga avokati.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.7/2023 të datës 10.01.2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.10 të datës 26.12.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve, menjëherë nga data e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguajë kreditorit shumën prej 701

Euro me kamatë ligjore prej 8 % nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri për përmbushjen definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, me arsyetimin se organi përbarues me rastin e zhvillimit të procedurës së përbarimit ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së. Më tej ka theksuar se urdhri është lëshuar mbi bazën e faturës së pa nënshkruar dhe të pa vulosur nga debitori, pa ndonjë bazë/kontratë mbi të cilën kreditori ka qenë i angazhuar të kryejë punë për debitorin, dhe e cila faturë është kundërshtuar nga debitori përmes e-mailit të bashkangjitur si provë. I ka propozuar gjykatës që të miratohet si i bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit P.nr.7/23 të datës 10.01.2023, si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t'ia paguajë shpenzimet për hartimin e prapësimin në vlerë prej 104.00 Euro.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe pa mbështetje ligjore, për faktin se nuk është shkelur asnjëra nga dispozitat ligjore të LPP-së. Më tej ka theksuar se debitori me qëllim po i shmanget pagesës së faturës së fundit me nr.10 në vlerë prej 701 Euro, duke u përgjigjur se nuk janë kryer shërbime nga ana e kreditorit, por një gjë e tillë nuk qëndron pasi që kreditori ka kryer shërbimet e kontraktuara, dhe Komuna e Suharekës si punëdhënëse e ka paguar debitorin në shumën prej 701 Euro. Ka shtuar se kreditori faturën për përmbushje ia ka dërguar debitorit përmes e-mailit, mirëpo i njejtë me qëllim që ta zvarrit çështjen e ka kundërshtuar atë. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, ndërsa të mbetet në fuqi urdhri i Përbaruesit Privat, si dhe për propozimin për përbarim të paguhet shuma prej 104 Euro, ndërsa për përgjigje në prapësim shuma prej 208 Euro.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përbarimor duhet të anulohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata gjeti se fatura nr.10 e datës 26.12.2022, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmban nënshkrimin e as vulën e pranuesit– debitorit.

Duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur, si e tillë nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar detyrimin që rrjedh nga fatura.

Gjykata vlerëson se meqenëse kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë nga e cila rezulton se pranimi i faturës konkrete është bërë në mënyrë të rregullt nga debitori pa e kundërshtuar atë, atëherë rezulton se fatura e lartcekur nuk mund të paraqes bazë për lejimin e përmbarimit.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e debitorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të prapësimit, ndërsa lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 par.2 LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbarimit, numri i palëve të përfaqësuara, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.710/23, më datë 14.05.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.